



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.0802-113
13.03.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Vendimin PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin me nr.ark.0201-1153/7 datë 12.03.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 9-të mbajtur më 12.03.2024 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio, pushon (ndalon) së vlefshimi me Ligj, me heqjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) nga neni i cituar i Ligjit, Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja mbaron së vlefshimi në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 8-të mbajtur më 01.03.2024, në pajtim me Konkluzionin me nr.ark.0201-1054/5 datë 01.03.2024, miratoi Vendim PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024, me të cilën i hiqet leja Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023, për shkak se zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio në afatin e përcaktuar me Ligj prej - 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës me nr.2024-100-0055 datë 11.01.2024. (nr ynë.ark.0503-232/1 datë 11.01.2024).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lartë, dhe në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, dhe në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar), Vendimin PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin me nr.ark.0201-1153/7 datë 12.03.2024, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 9-të mbajtur më 12.03.2024, miratoi aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.